



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ROSKOVEC

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE ÇËSHTJEVE JURIDIKE
SEKTORI I SEKRETARI-ARKIVIT

KARTELË SHOOËRUESE E PRAKTIKËS

Dërgues Prefekti i Qarkut Fier Nr.Prot. 424/, Data 05.05.2014

Shkurtimi i lëndës Izhi m. pengje

Për trajtim nga:	
(struktura të tjera të ngarkuara)	<u>Sp. Arllata (Hjelm)</u>
Me porosi:	<u>Sp. Belina Horha</u> <u>Sp. Eneda Hoxha</u> <u>Me porosi</u>

03.05.2014

Afati: normal (7 ditë) Prioritet (3 ditë) Urgjent (Brenda ditës) Pa afat/ për dijenë Tjetër ___ ditë

Data 03.05.2014, Nr.Prot 3109/

Nënshkrimi: (TITULLARI) _____

Marrë në dorëzim: _____

Nënshkrimi _____

Kalon për trajtim (struktura): _____

Me porosinë: _____

Marrë në dorëzim: _____

Nënshkrimi _____

Kalon për trajtim (struktura): _____

Me porosinë: _____

Marrë në dorëzim: _____

Nënshkrimi _____

Kalon për trajtim specialisti: _____

Me porosinë: _____

Trajtim i materialit përfunduar më: _____, Specialisti

Trajtim i materialit pranuar më: _____, Eprori në shkallë hierarkike

Trajtim i materialit miratuar më: _____, Eprori në shkallë hierarkike

Trajtim i materialit miratuar më: _____, Eprori në shkallë hierarkike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT FIER
SEKTORI JURIDIK

Nr. 474 / Prot. 11

Fier, më 02.05.2024

Lënda: Kthim përgjigje për verifikimin e ligjshmërisë së vendimit Nr. 30, të Këshillit të Bashkisë Roskovec, të miratuar në mbledhjen e datës 26.04.2024.

BASHKISË ROSKOVEC
KËSHILLIT TË BASHKISË ROSKOVEC
Roskovec

Në përgjigje të shkresës tuaj me Nr. 3109 prot. datë 26.04.2024, protokolluar pranë Prefektit të Qarkut Fier me Nr. 474 prot. datë 30.04.2024, bazuar në Ligjin Nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut” neni 8, shkronja “a”, neni 16, si dhe në Ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3, pika 2, morëm në shqyrtim vendimin Nr. 30 datë 26.04.2024 me karakter normativ të Këshillit të Bashkisë Roskovec, të miratuar në mbledhjen e datës 26.04.2024, shoqëruar me procesverbalin e mbledhjes Nr. 5, datë 26.04.2024, të mbajtur në Librin e Procesverbalit të Mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Roskovec me Nr. 69, prot. datë 05.01.2024, si dhe dokumentacionin plotësues të vendimit.

Vendimi i Këshillit të Bashkisë Roskovec Nr. 30, datë 26.04.2024, “Për miratimin e dokumentit të rishikimit të planit të përgjithshëm vendor të Bashkisë Roskovec me procedurë të thjeshtuar” është i shoqëruar nga projektvendimi Nr. 30, datë 22.04.2024 protokolluar me Nr. 2940 prot. datë 22.04.2024; relacioni shpjegues Nr. 2940/1 prot. datë 22.04.2024, procesverbalet e dëgjësave publike Nr. 30 datë 16.01.2024; Nr.2, datë 15.04.2024 dhe Nr. 3, datë 15.04.2024 si dhe dokumentacion shtesë që lidhet me procedurën e ndjekur.

Për këtë vendim shprehemi si më poshtë vijon:

Nga relacioni bashkëlidhur vendimit rezulton se Bashkisë Roskovec i ka lindur nevoja të rishikojë Planin e Përgjithshëm Vendor të miratuar me vendim Nr. 4, datë 10.06.2020 të Këshillit Kombëtar të Territorit. Ligji Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (i ndryshuar) neni 13 parashikon se:

Kryetari i bashkisë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, është përgjegjës për:

- a) zhvillimin e territorit vendor, përmes hartimit dhe zbatimit të dokumenteve të planifikimit të territorit;*
- b) ndërmarrjen e nismës për hartimin dhe rishikimin e dokumenteve vendore të planifikimit;*
- c) hartimin apo rishikimin e dokumenteve të planifikimit të territorit në përputhje të plotë me*

Planin e Përgjithshëm Kombëtar të Territorit dhe, sipas rastit, në përputhje me planet sektoriale dhe planet e detajuara për zonat me rëndësi kombëtare, si dhe duke iu përmbajtur normave teknike të planifikimit të territorit;

ç) koordinimin mes institucioneve publike dhe alokimin e burimeve njerëzore të nevojshme për hartimin e dokumenteve të planifikimit në nivel vendor;

d) dorëzimin dhe prezantimin e planit të përgjithshëm vendor pranë AKPT-së, për të verifikuar përputhshmërinë me Planin e Përgjithshëm Kombëtar të Territorit dhe normat teknike të planifikimit;

dh) miratimin e planeve të detajuara vendore.

Në zbatim të detyrimeve ligjore Kryetari i Bashkisë Roskovec ka ndërmarrë Nismën me vendimin Nr. 153, datë 29.12.2023 “Për ndërrmarjen e Nismës për Rishikimin e Dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Roskovec me procedurë të thjeshtuar”.

Me shkresën Nr 510. prot, datë 25.01.2024 Bashkia Roskovec ka njoftuar Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit mbi Nismën për rishikimin e pjesëshëm të Planit të Përgjithshëm Vendor me procedurë të thjeshtuar si dhe ka kërkuar qëndrimin e saj mbi nevojën ose jo që rishikimi i dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor, me procedurë të thjeshtuar, t’i nënshtrohet procesit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor.(VSM)

Me shkresën Nr.676/1 Prot datë 29.02.2024 Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është shprehur se Bashkia Roskovec mund të vijojë procedurat për rishikim e PPV-së me procedurë të thjeshtuar pa pasur nevojë t’i nënshtrohet VSM-së. Me shkresën Nr.2077 Prot, datë 20.03.2024, Bashkia Roskovec i ka kërkuar Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT-së) lëshimin e Aktit të Përputhshmërisë për Dokumentin e Rishikimit të Planit Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Roskovec. Me shkresën Nr. 324/02 datë 21.03.2024, AKPT-ja i ka dërguar Bashkisë Roskovec Aktin e Përputhshmërisë Nr. 324/01 datë 21.03.2024 “Për Dokumentin e Rishikimit të Planit Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Roskovec”.Rezulton se Akti i Përputhshmërisë Nr. 324/01 datë 21.03.2024 është lëshuar me kusht për njësinë strukturore RO_IN_IENI_19/1.

Procedura e ndjekur nga Bashkia Roskovec është publikuar në RKPT (Regjistri Kombëtar i Planifikimit të Territorit). Procedura e ndjekur është koordinuar hap pas hapi me AKPT-në. Nga ana e Bashkisë Roskovec dhe Këshillit Bashkiak Roskovec janë zhvilluar dëgjesa publike me banorët e zonave që preken nga ndryshimet e PPV-së, vërtetuar kjo gjë me procesverbalet e dëgjesave publike Nr. 30 datë 16.01.2024; Nr.2, datë 15.04.2024 dhe Nr. 3, datë 15.04.2024.

Bazuar në Ligjin Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (i ndryshuar) neni 12 pika 2 shkronja “a” *Këshilli bashkiak është përgjegjës për të miratuar rishikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor.* Rishikimi i Planit të Përgjithshëm Vendor me procedurë të thjeshtuar parashikohet me VKM NR. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit” (i ndryshuar) nenet 11 dhe 12. Kryetari i bashkisë në bazë të nenit 62 të VKM NR. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit” (i ndryshuar) si autoriteti përgjegjës për hartimin e planit, paraqet për miratim planin ose pjesët përbërse të tij në këshillin bashkiak në përputhje me nenet 12 pika 2 dhe 13 të Ligjit Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (i ndryshuar).

Udhëzimi Nr.1 datë 06.12.2021 “Për hartimin, bashkërendimin, miratimin dhe kontrollin e procesit të rishikimit të dokumenteve të Planeve të Përgjithshme Vendore me procedurë të thjeshtuar” (i ndryshuar) pika 3 përmban hapat për procedurën e thjeshtuar.

Këto hapa janë si më poshtë:

- a. *Ndërmarrja e Nismës për rishikimin e Dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor,*
- b. *Hartimi i Dokumentit të ndryshimeve të Planit të Përgjithshëm Vendor,*
- c. *Procesi i Bashkërendimit , këshillimit dhe takimeve publike,*
- d. *Procesi i miratimit të Dokumentit të Rishikuar të Planit të Përgjithshëm Vendor.*

Nga dokumentacioni bashkëlidhur vendimit rezulton se procedura është ndjekur nga të gjithë aktorët që marrin pjesë në këtë proces.

Për sa më sipër:

Vendimi i Këshillit të Bashkisë Roskovec Nr. 30, datë 26.04.2024, “Për miratimin e dokumentit të rishikimit të planit të përgjithshëm vendor të Bashkisë Roskovec me procedurë të thjeshtuar” Është në përputhje me ligjin Nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar) neni 8, pika 2, neni 9, pika 1/1.1 shkronja “b”, neni 23 pika 14; Ligjin Nr. 107/2014, datë 31.04.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i (ndryshuar) neni 12 pika 2 shkronja “a” neni 26 ; VKM NR. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit” (i ndryshuar) nenet 11, 12 si dhe në zbatim të Udhëzimi Nr.1 datë 06.12.2021 “Për hartimin, bashkërendimin, miratimin dhe kontrollin e procesit të rishikimit të dokumenteve të Planeve të Përgjithshme Vendore me procedurë të thjeshtuar” (i ndryshuar) pika 3, si dhe Shtojcës 1 bashkëlidhur këtij Udhëzimi pika 6 shkronja “b”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

**NË MUNGESË
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Arben Velo

